



# UNIVERSITETI I SHKODRËS

## “Luigj Gurakuqi”

SENATI

Nr. 722 prot.

Shkodër, më 29.02. 2017

### V E N D I M

nr. 71, datë 29. 2017

#### “ P Ë R MIRATIMIN E STRATEGJIVE SEKTORIALE TË USH-SË”

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë” neni 38, Statutit të Universitetit, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 24.02.2017:

#### V E N D O S I:

1. Miratimin e strategjive sektoriale të USH-së sipas materialeve bashkëngjitur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Rektori

Prof.dr. Adem BEKTESHI





STRATEGJIA E NDËRKOMBËTARIZIMIT  
E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS  
*“LUIGJ GURAKUQI”*

---



## Përmbajtja

Lista e shkurtimeve .....	3
Hyrje.....	4
Filozofia jonë e ndërkombëtarizimit .....	4
Parimet e përgjithshme .....	5
Kultura e bashkëpunimit dhe reciprociteti.....	5
Angazhimi.....	5
Përgjegjshmëria sociale .....	5
Cilësia .....	5
Fokusi rajonal.....	5
Fokusi tek studentit.....	5
Parimi i transparencës .....	5
Parimi i lidhjeve afatgjata.....	5
Qëllimi.....	6
Objektivat.....	6
Fushat e ndërkombëtarizimit.....	6
Skemat e bursave .....	6
Partneritetet .....	6
<input type="checkbox"/> <i>Partneritetet e mësimdhënies</i> .....	7
<input type="checkbox"/> <i>Partneritetet kërkimore</i> .....	7
<input type="checkbox"/> <i>Partneritetet për mobilitetin e studentëve</i> .....	7
Kurrikula ndërkombëtare .....	8
Kërkimi .....	8
Mobiliteti i stafit akademik.....	9
Plani i veprimit 2017-2020 .....	9
Aneksi Nr 1. Përvojat e Fakulteteve të USH për partneritet e mësimdhënies.....	12
Aneksi Nr 2. Modulet në gjuhën angleze të ofruara nga USH .....	13
Aneksi Nr 3. Përvoja e USH në mobilitetin e studentëve.....	13
Aneksi Nr 4. Bashkëpunimet e USH për hartimin e kurrikulave ndërkombëtare ...	14



Ankesi Nr 5. Lista e projekteve ndërkombëtare të zhvilluara në USH .....14  
Aneksi Nr 6. Tabela e marrëveshjeve të Credit Mobility (KA1) .....18  
Aneksi Nr 7. Të dhëna mbi mobilitetin në USH.....19

**Lista e shkurtimeve**

- CEEPUS - "Central European Exchange Program for University Studies
- CISVA - Centro Interuniversitario degli Studi del Viaggio Adriatico
- DZHMJ – Dega e Marrëdhëniev me Jashtë
- FE - Fakulteti Ekonomik
- FSHE - Fakulteti i Shkencave të Edukimit
- FSHN - Fakulteti i Shkencave të Natyrës
- FSHSH - Fakulteti i Shkencave Shoqërore
- TIK – Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit
- MAS - Ministria e Arsimit dhe Sportit
- USH - Universiteti i Shkodrës



## Hyrje

Strategjia e ndërkombëtarizimit të Universitetit të Shkodrës është pjesë përbërëse e strategjisë kryesore të këtij Universiteti. USH synon të rrisë reputacionin e saj ndërkombëtar përmes cilësisë së arsimit që siguron, ndikimit të kërkimeve që ajo realizon dhe shërbimeve që ofron për shoqërinë. Ndërkombëtarizimi përfshin të gjitha aspektet e jetës universitare: kërkimin, mësimdhënien dhe administrimin. Nëpërmjet kësaj strategjie synohet një shkallë më e lartë njohje e këtij universiteti në rajon dhe më gjerë duke promovuar aktivitetet e tij. Aktivitetet ndërkombëtare të Universitetit të Shkodrës janë stimuj të kërkimit shkencor, rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe përditësimit të metodave të mësimdhënies. Këto aktivitete janë gjithashtu një aspekt kyç i veprimit të Universitetit. Përmes projekteve kërkimore ndërkombëtare, mobiliteteve të studentëve, administratës e shërbimeve si dhe stafit akademik, mund të kontribuohet në rritjen e cilësisë së administrimit të universitetit, mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, në të gjitha fushat që mbulon universitetin.

Të jesh një universitet ndërkombëtar do të thotë: Të zhvillosh komunitete multikulturore të studentëve dhe stafit; Të sigurosh mjedis mbështetës për përvojën arsimore që përgatit studentët për mjediset politike dhe sociale globale; Të zhvillosh aleanca dhe partneritete ndërkombëtare për të mbështetur dhe ngritur kapacitetet dhe aftësitë në kërkim, edukim dhe sipërmarrje. Ndërkombëtarizimi i USH ndihmon në rritjen e autoritetit dhe vizibilitetit të USH në mjediset universitare e më gjerë, duke u përfshirë në një numër më të madh bashkëpunimesh dhe partneritetesh më të ngushta dhe me cilësore me universitete të huaja dhe institute kërkimore ndërkombëtare. Përmes strategjisë së ndërkombëtarizimit stafi dhe studentët e një sërë programesh studimi, do të kenë mundësi udhëtimi që do t'i ndihmojnë ata të kenë sukses në pozicionet e tyre në tregun e punësimit global.

## Filozofia jonë e ndërkombëtarizimit

Politika e bashkëpunimit ndërmjet Universitetit të Shkodrës dhe Universiteteve të tjera të huaja konkretizohet me nënshkrimin e marrëveshjeve respektive të cilat nxisin aktivitetet e mëposhtme:

- Shkëmbime dhe bashkëpunime reciproke të profesorëve, kërkuesve, studentëve dhe stafit administrativ në nivelin universitar dhe pas universitar;
- Organizimi i shkollave verore, seminareve dhe formave të tjera shkëmbimi njohurish nga palët;
- Shkëmbim literature, teksteve dhe publikimeve universitare;
- Realizimi i projekteve të përbashkëta;
- Shkëmbime eksperiencash në programe reciproke në fushën e sistemeve të informacionit dhe komunikimit;
- Shkëmbim stafi administrativ me qëllim përfitim experience në mirë menaxhimin e Universitetit;
- Bashkëpunimi në fushën e reformës universitare sipas Deklaratës së Bolonjës dhe Deklaratës së Lisbonës;
- Krijimi i grupeve të përbashkëta kërkimore për fusha që mbulon Universitetin;
- Krijimi i masterave të përbashkëta;
- Si dhe forma të tjera bashkëpunimi me qëllim që të jenë reciprokisht përfituese për të dyja palët.



## Parimet e përgjithshme

- **Kultura e bashkëpunimit dhe reciprociteti.**

Ndërkombëtarizimi është një proces i dyanshëm. Puna shumëpalëshe do të na japë mundësi të arrijmë objektivat në termat e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe transferimit të dijeve. USH i kushton rëndësi krijimit dhe zhvillimit të një kulture bashkëpunimi ndërkombëtare dhe përfitimit të ndërsjellë. Kjo realizohet nëpërmjet krijimit të kushteve më të mira dhe krijimit të mekanizmave e procedurave që nxisin dhe mbështesin aktivitetet e ndërkombëtarizimit. Ne do të fokusohemi në kultivimin e marrëdhënieve të shumëfishta duke eliminuar barrierat dhe duke u nisur nga përfitimi reciprok i palëve të përfshira.

- **Angazhimi**

Ndërkombëtarizimi është një investim për të ardhmen dhe kërkon angazhim afatgjatë si nga ana e stafit të USH ashtu edhe nga ana e studentëve dhe e partnerëve.

- **Përgjegjshmëria sociale**

Arsimi i lartë është një e mirë publike dhe sociale. Si e tillë USH ndjen përgjegjësinë për të gjeneruar dhe ndarë dijet, njohuritë për më të mirën e shoqërisë. Gjithashtu USH është sensitiv edhe ndaj ngjarjeve dhe zhvillimeve rajonale. Ne jemi të angazhuar të zhvillojmë kapacitetet jo vetëm në vendin tonë i cili konsiderohet si një vend në zhvillim, por edhe në rajon (BALLKAN) duke ndikuar kështu në një qëndrueshmëri më të lartë.

- **Cilësia**

Ne kemi si qëllim të mbajmë standarde të larta në të gjitha aktivitetet që ndërmarrim.

- **Fokusi rajonal**

USH ka si qëllim të përqendrojë përpjekjet dhe burimet e saj edhe në bashkëpunimet me vendet e rajonit.

- **Fokusi tek studentit**

Studentët janë një forcë shumë e madhe shtytëse e ndërkombëtarizimit. Ne synojmë që iniciativat dhe programet ndërkombëtare të marrin në konsideratë në mënyrë sistematike nevojat, pritshmëritë dhe eksperiencat e studentëve. Ne besojmë se studentët duhen fuqizuar që të aktivizohen dhe menaxhojnë vetë aktivitete ndërkombëtare. Projektet dhe organizata studentore do të jenë krahu ynë i djathtë dhe do të mbështeten, asistohen dhe trajnohen për të angazhuar në aktivitete ndërkombëtare.

- **Parimi i transparencës**

USH i kushton rëndësi vënies në dispozicion të të gjithë informacionit të vlefshëm për stafin dhe studentët për t'u njohur me mundësitë e bashkëpunimit dhe mobiliteteve të dyanshme, si dhe zbatim transparent të procedurave përkatëse.

- **Parimi i lidhjeve afatgjata**

USH i kushton rëndësi krijimit dhe ruajtjes së lidhjeve afatgjata me ish-studentët (alumni) dhe ish-anëtarë të stafit akademik që punojnë në universitete të huaja, institute kërkimore ose organizata të tjera. Përfshirja e kapaciteteve intelektuale të diasporës shqiptare dhe alumni kontribuon në shtimin e potencialeve në USH në fusha të ndryshme duke rritur kështu nivelin e shkëmbimit dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar.



## Qëllimi

Universiteti i Shkodrës nxit veprimtaritë ndërkombëtare dhe inkurajon zbatimin e tyre në të gjitha aktivitetet e përditshme të Universitetit. Zhvillimi strategjik i Universitetit është i bazuar në orientimin e tij ndërkombëtar dhe vë theksin e tij në rëndësinë e të qenit pjesë e zonës Evropiane të Arsimit të Lartë. Mobiliteti i stafit akademik, administratës, shërbimeve dhe studentëve, si një pjesë e bashkëpunimit ndërkombëtar është një qëllim strategjik shumë i rëndësishëm në zhvillimin e Universitetit të Shkodrës. Në kuadër të ndërkombëtarizimit qëllimi i USH është: 1) Të nxisë dhe përmirësojë cilësinë e jetës jo vetëm të shqiptarëve por edhe të vendeve të tjera dhe kjo përmes qasjes sonë të ndërkombëtarizimit në nivelin e kërkimit shkencor dhe mësimdhënies. Konkretisht kjo synohet të realizohet përmes kërkimeve, zbulimeve, shpërndarjes së dijeve dhe inovacionit. 2) Të sigurojë mësimdhënie, kërkim shkencor dhe transferim të dijeve drejt grupeve të interesit të jashtëm, në nivel sa më të lartë dhe të ngjashëm me standardet ndërkombëtare. Strategjia e ndërkombëtarizimit të USH buron nga strategjia e përgjithshme e USH dhe vjen në përputhje të plotë me këtë të fundit.

## Objektivat

- Të zgjerojë, inkurajojë dhe mbështesë mobilitetin për studentët, stafin dhe kërkuesit.
- Të promovojë dhe mbështesë bashkëpunimit kërkimor ndërkombëtar dhe aktivitetet kërkimore në nivel ndërkombëtar.
- Të rrisë ndikimin e kërkimit tonë dhe të komercializimit të aktiviteteve. Të jetë sa më atraktiv për kërkuesit, profesorët, studentët dhe stafet e tjera jashtë vendit.
- Të zhvillojë dhe përmirësojë mësimdhënien ndërkombëtare dhe partneritetin në kërkim.
- Të pasurojë programet me përmbajtje ndërkombëtare.

## Fushat e ndërkombëtarizimit

### Skemat e bursave

Qëllimi i USH është të rrisë mundësitë e shkëmbimit në Evropë dhe më gjerë duke rritur numrin e studentëve që përfitojnë nga mundësitë për të studiuar jashtë vendit si pjesë e studimeve të tyre në USH. Për të rritur shkallën e pjesëmarrjen dhe për të mbështetur studentët në aktivitetet e tyre ndërkombëtare, USH është e angazhuar të pakësojë pengesat financiare për studentët që në mënyrë periodike dëshirojnë të ndjekin studimet jashtë vendit. Një sërë bursash studimore u janë ofruar studentëve dhe stafit, dhe kjo bazuar në varësi të destinacionit të studimit, nevojave financiare dhe meritës akademike. P.sh., Fakulteti i Shkencave të Edukimit ka qenë pjesë e projektit Tempus me titull “Quality in Research” ku stafi i tij ka qenë edhe pjesëmarrës por edhe përfitues i disa bursave të ofruara nga ky projekt. Credit Mobility është një program tjetër që ofron bursa të cilat ofrohen programe të Bashkimit Evropian për Arsimin e Lartë. Universiteti gjithashtu po punon për të gjetur sponsor të jashtëm ose donatorë në mënyrë që të ofrojë bursa të reja studimore për studentët

### Partneritetet

Ush është e angazhuar të zhvillojë partneritete në shkallë rajonale dhe globale. Qasja jonë ndaj partneritetit është bashkëpunimi me partnerë dhe me grupe interesit me të cilët ndajmë qëllime dhe interesa të përbashkëta. Ne kërkojmë të ndërtojmë partneritete mbi bazën e qëndrueshmërisë dhe reciprocitetit. Këto partneritete ndahen në tre fusha të rëndësishme: Partneritet e mësimdhënies; partneritetet kërkimore; partneritetet për mobilitetin e studentëve.



- *Partneritetet e mësimdhënies*

USH inkurajon zhvillimin e partneriteteve ndërkombëtare në mësimdhënie me institucione cilësore kudo në botë. Aktualisht USH ka marrëveshje me 75 Universitete dhe Institucione dhe partneritete aktive në mësimdhënie duke u siguruar studentëve mundësi studimi ndërkombëtare, inovative dhe interesante. Ne mirëpresim iniciativa të tjera për bashkëpunime rajonale dhe më gjerë në fushën e mësimdhënies. Politika që ka ndjekur USH është ajo e zgjerimit të rrjetit të bashkëpunimeve me synimin e shkëmbimit të eksperiencave më të mira e cila sigurisht mbetet në të njëjtën linjë me strategjinë e Universitetit. Prioritete të bashkëpunimeve kanë qenë shkëmbimet e eksperiencave dhe të stafit me qëllim përmirësimin e cilësisë së kurrikulave dhe të mësimdhënies. Përvojat e Fakulteteve të USH për partneritetet e mësimdhënies gjenden tek Aneksi Nr 1. Procesi i ndërkombëtarizimit të ballafaqon edhe me sfida, një prej të cilave është edhe gjuha. Për këtë arsye USH synon të sigurojë informacione thelbësore në gjuhën Angleze duke e konsideruar atë si një gjuhë ndërkombëtare. Për këtë arsye të gjitha lajmërimet, materialet informuese, faqja zyrtare e web e USH etj në të ardhmen do të jenë edhe në gjuhën angleze. Në kuadër të projekteve Credit mobility KA1 është mjaft e rëndësishme që Fakultetet të ofrojnë sa më shumë lëndë në gjuhë të huaj. Në fakt një theks i është vënë mësimdhënies në gjuhën angleze dhe deri tani Universiteti i Shkodrës ofron në sërë modulesh të pasqyruara në Aneksin Nr 2.

- *Partneritetet kërkimore*

Bashkëpunimi në kërkimin shkencor është një pjesë e rëndësishme e axhendës së USH ne bashkëpunojmë me qendra të tjera kërkimore dhe të ekselencës për çështje me rëndësi rajonale dhe globale dhe jemi të angazhuar të rrisim standardet. USH ka partneritetet me universitete të tjera (industri) duke na mundësuar që të jemi pjesë e projekteve kërkimore në një shkallë ndërkombëtare dhe të transferojmë dijet tona në botë. Psh: FSHE ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me UBT në kuadër të bashkëpunimit për organizimin e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare ICRAE 2015. FSHE dhe konkretisht Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale ka lidhur në dhjetor të 2013 marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Studimeve të Firences (Itali), Departamenti i Shkencave Politike dhe Sociale. Në kuadër të bashkëpunimit janë realizuar në mënyrë reciproke vizita studimore në universitetet respektive si dhe janë mbajtur leksione/referate për studentët e nivelit bachelor dhe master nga pedagogët përfaqësues të projektit nga të dy departamentet. Fakulteti i Shkencave të natyrës shquhet për organizimin e konferencave shkencore ndërkombëtare në bashkëpunim me BENA (Balkan Environmental Association) në të cilën pjesëmarrës janë kërkues të një niveli të lartë në fushën e shkencave të natyrës.

- *Partneritetet për mobilitetin e studentëve*

USH është e angazhuar të rrisë mundësitë e studimit jashtë vendit për studentët e të gjitha Fakulteteve dhe departamenteve. USH njeh dhe vlerëson përfitimet e mëdha nga ngritja dhe mbajtja e partneriteteve si për USH ashtu edhe për Universitetet partnere. Këto përfitime përfshijnë: Krijimi i kurseve të reja dhe inovative dhe ndërkombëtare; Mundësi për të zhvilluar dhe fuqizuar partneritetin kërkimor mes akademikëve; Krijimin e mundësive për mobilitet të studentëve; Rritja profilit dhe markës së USH dhe Universiteteve partnere; Mundësia për të lëvruar fonde të reja si psh ato të Erasmus +, etj

Në mënyrë që të kemi një mobilitet sa më të sukseshëm të studentëve, Fakulteteve të Universitetit të Shkodrës i del detyra që të përafrojnë kurrikulat e tyre sa më shumë që të jetë e mundur me ato të Universiteteve perëndimore. Hartimi i këtyre kurrikulave lidhet dhe me ekselencën shkencore dhe mësimore të USH e cila duhet të njihet në tregun European të Universiteteve. Një element i rëndësishëm i mobilitetit të studentëve është fakti që programet e





studimit që ofron USH të respektojnë standardet dhe kërkesat e Marrëveshjes së Bolonjës. Programet organizohen dhe vlerësohen në kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe të Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Vendosja e ECTS të krediteve krijon mundësinë për të arritur standartet evropiane të Arsimit të lartë, për të lehtësuar lëvizjen e studentëve nëpërmjet njohjes së rezultateve në nivel jouniversitar, universitar dhe pasuniversitar si dhe u krijon mundësi studentëve për njohjen e krediteve në programe të tjera të ngjashme në Evropë. Përdorimi i sistemit ECTS rrit transparencën e programeve të studimit dhe kualifikimeve universitare dhe lehtëson njohjen e studimeve dhe të diplomave. Deri tani politika për mobilitetin e studentëve është bazuar në nxitjen e studentëve të aplikojnë për studime semestrale në universitete të huaja si dhe të ftojë studentë të huaj për të studiuar në USH. Kjo bën pjesë edhe në punën për ndërkombëtarizimin e USH-së. Për këtë USH është përpjekur të gjallërojë jetën studentore duke i krijuar lehtësira për ushtrimin e aktiviteteve brenda Universitetit si dhe të nxisë lidhjet e studentëve të USH me studentët e universiteteve të tjera nëpërmjet aktiviteteve të përbashkëta. Përveç kësaj USH ka ftuar për studime të pjesshme semestrale studentë nga universitete të huaja që dëshirojnë të studiojnë në USH. Disa të dhëna mbi mobilitetin e studentëve të USH i gjeni tek Aneksi Nr 3.

### **Kurrikula ndërkombëtare**

USH synon të jetë një institucion global. Për të siguruar studentëve tanë një eksperiencë globale, ne sigurohemi që të gjitha aspektet globale të jenë të pranishme në të gjitha fushat e jetës së USH. Kjo do të thotë që ne përpiqemi të ofrojmë kurrikulat të ngjashme me ato ndërkombëtare. Në këtë mënyrë ne sigurohemi që studentët tanë të jenë të përgatitur dhe të aftë për të qenë qytetarë globalë dhe tu rrisim atyre mundësitë e punësimit. Për këto arsye USH është vazhdimisht e angazhuar dhe e fokusuar në: Ndërkombëtarizimin e përmbytjes së programeve dhe kurseve aktuale që USH ofron; Zhvillimin e programeve me fokus ndërkombëtar; Rritjen e shkathtësive dhe kompetencave gjuhësore të studentëve. Në shumicën e programeve e nivelit BA është e detyruar lënda “Gjuhë Angleze”. Gjithashtu përveç kësaj lënde, programet e studimeve përmbyjnë edhe një lëndë me zgjedhje “Gjuhë e huaj: Frëngjisht, Italisht; Gjermanisht; Turqisht; Gjuhë malazeze. Një nga qëllimet e USH është të integrojë në kurrikulat aktuale edhe lëndë (të detyrueshme ose me zgjedhje, kjo në varësi të specifikave të kurseve studimore) që i prezantojnë studentët me çështje globale si p.sh: kultura globale dhe shoqëria, politikat globale, shëndeti global si dhe fusha të tjera me në fokus çështjet globale. Informacione më të detajuara në lidhje me arritjet e USH në fushën e hartimit të kurrikulave ndërkombëtare e gjeni në Aneksin nr 4.

### **Kërkimi**

Zhvillimi i kërkimit është një nga objektivat themelor të planit strategjik të USH. USH është e angazhuar të ndërmarri kërkime në nivel rajonal dhe global në bashkëpunim me institucione të tjera. Objektivi i rëndësishëm i Universitetit të Shkodrës si dhe gjithë studentëve që studiojnë në universitetin tonë është njohja në shkallë ndërkombëtare e diplomës që studenti merr gjatë studimit në universitet. Arritja e këtij objektivi është e lidhur dhe me cilësinë e mësimdhënies, nivelin e stafit akademik, nivelin e studentëve, kushteve të studimit (raportet staf akademik/student, sipërfaqe / student etj). Plotësimi shkallë-shkallë i këtyre kushteve ofron realizimin e objektivit strategjik më të rëndësishëm në shkallën e ndërkombëtarizimit të USH. Zbatimi i projekteve ndërkombëtare ka ndihmuar në gjetjen e partnerëve strategjikë në kërkimin shkencor brenda dhe jashtë vendit. USH ka krijuar një traditë me pjesëmarrje në projektet TEMPUS (sot Erasmus +) ku ka qenë partner. Në vitet në vazhdim synohet të punohet



për të hartuar projekte shkencore ku USH të ketë rol drejtues. USH synon hartimin e projekteve në kuadër të Erasmus + (KA1 dhe KA2), Horizon 2020 dhe projekte të tjera të Komunitetit Evropian. Po ashtu është punuar për të krijuar një profil kombëtar dhe ndërkombëtar të USH në lidhje me mësimdhënien dhe kërkimin shkencor duke organizuar mësimdhënien në tre nivelet që të jenë tipike për USH. USH është e angazhuar të ndërmarrë dhe të mbështesë një rang të gjerë dhe divers të aktiviteteve kërkimore ndërkombëtare. Përmirësimi i lidhjeve ndërkombëtare lidhet fort me angazhimin e anëtarëve të USH në rrjetet akademike ndërkombëtare, bashkë-publikimet me kolegë ndërkombëtarë dhe me mundësinë e tyre për të publikuar studimet në revista ndërkombëtare sa më prestigjioze. Nëpërmjet bashkëpunimit me Departamentin e Fizikës të Universitetit të Bolonjës është arritur të realizohen disa leksione dhe seminare me grupe studentësh nga një anëtar i stafit të secilit prej departamenteve bashkëpunues, si dhe është shfrytëzuar momenti për të organizuar një sesion shkencor. Në FSHN, kërkuesit e huaj janë të integruar në kërkime të përbashkëta në fushën e Infermierisë, Biologji-Kimisë, Fizikës dhe Informatikës. Tradicionalisht, projektet ndërkombëtare kërkimore janë realizuar me anë të përpjekjeve të stafit akademik dhe administrativ që bëjnë gjithë punën e nevojshme dhe japin ekspertizën e tyre gjatë fazave të shkrimit dhe zbatimit të projekteve. Universiteti vlerëson angazhimin e stafit të vet në projekte dhe e konsideron këtë mjet si mjaft të fuqishëm për promovimin e reputacionit të vetë Universitetit. Në Aneksin Nr 5 gjendet lista e projekteve ndërkombëtare të zhvilluara në USH. Në Aneksin Nr 6 gjendet tabela e marrëveshjeve të Credit Mobility (KA1)

### **Mobiliteti i stafit akademik**

Mobilitetet synojnë forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dhe marrëveshjeve ekzistuese me Universitete të tjera (brenda dhe jashtë vendit), krijimin e marrëveshjeve të reja dhe ndërkombëtarizimin e Universitetit të Shkodrës. USH-ja ka qenë në lidhje të vazhdueshme me institucione homologe në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Informacioni për zhvillimet më të reja është siguruar me ndihmën e kontakteve të profesoratit të këtij universiteti me universitete të tjera si dhe nëpërmjet veprimtarive të përbashkëta në fushën e kërkimit shkencor e të mësimdhënies. Në kuadrin e bashkëpunimit me universitetet e tjera, pedagogët e USH-së kanë marrë pjesë në veprimtari të organizuara brenda dhe jashtë vendit, duke marrë informacione të reja në fushën e mësimdhënies, të programeve mësimore si dhe të objektivave që kanë këto për të ardhmen. Rëndësi i është kushtuar edhe stafik akademik të huaj që ka ardhur në Universitetin e Shkodrës Të dhënat më të detajuara mbi mobilitetin e stafit të USH i gjeni në Aneksin Nr 7. Universiteti i Shkodrës synon krijimin e mundësive për mobilitetin e stafit akademik përmes:

- Pjesëmarrjes në konferenca shkencore ndërkombëtare;
- Trajnimeve të përbashkëta me universitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor;
- Vizitave studimore në kuadër të shkëmbimit akademik bilateral me universitete të vendeve perëndimore;
- Mobiliteti i personelit akademik në universitete ndërkombëtare me qëllim kualifikimin e mëtejshëm të tyre.

### **Plani i veprimit 2017-2020**

<i>Objektivat</i>	<i>Detyrat (përshkrimi)</i>	<i>Afatet kohore</i>	<i>Burimet dhe personat</i>
-------------------	-----------------------------	----------------------	-----------------------------



			<i>përgjegjës</i>
1. Rritja e numrit të projekteve ndërkombëtare	1. Realizimi i një studimi lidhur me bashkëpunimin në fushën kërkimore të çdo pedagogu, departamenti, fakulteti me institucionet e huaja dhe mbi këtë bazë do të institucionalizohet ndihma dhe mbështetja financiare, në mënyrë që kjo lidhje të rritet dhe të zgjerohet në të ardhmen.	1 vit	Fakultetet +DZHMJ
	2. Përfshirje e ekspertëve dhe profesionistëve që kanë eksperiencë në përpilimin e projekteve. Afrimi i tyre pranë zyrës së Zhvillimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë do rrisë cilësinë e projekteve për konkurrim.	1 vit	DMZHJ, Rektori
	3. Zhvillim i mekanizmave dhe mjeteve për para-financim, ose krijimi i një "Fondi për mbështetjen e projekteve", i cili do të monitorojë faza përgatitore dhe fillestare të projekteve.	1 vit	Kancelari
2. Rritja e numrit të mobiliteteve të dyanshme të stafit dhe studentave.	1. Rikonceptim për organizimin e pjesëmarrjes në programet ndërkombëtare të lëvizjes së pedagogëve dhe studentëve.	2 vite	DZHMJ+Fakultetet
	2. Ofrimi i sa më shumë programe mësimore në gjuhë të huaj (me prioritet gjuha angleze), pasi kjo do të mundësojë ardhjen e shumë studentëve të huaj në Universitetin tonë për ndjekjen e moduleve të ndryshme. Në fakt kjo është edhe një kërkesë kryesore në kuadër të aplikimeve të Erasmus+ (Credit Mobility).	2 vite	Zyra Kurrikulave+Fakultetet
	3. Persa i përket Marrëveshjeve Credit Mobility (KA1) do të punohet për rinovimin dhe zgjerimin me marrëveshje të reja duke zgjeruar fushën e studimit (përgjithsisht është vetëm në fushën e ekonomisë) si dhe rritjen e mundësive të aplikimit për stafin administrativ.	2 vite	DMZHJ+Fakultetet
3. Zgjerimi i rrjetit të institucioneve partnere.	1. Krijim i partneriteteve me universitetet, organizatat kërkimore dhe institucionet e tjera të arsimit të lartë, sidomos me ato të rajonit, duke theksuar marrëveshjet me universitetet shqipfolëse, me prioritet intensifikimin e shkëmbimeve të pedagogëve dhe studentëve.	2 vite	DZHMJ+Dekanet
	2. Forcimi i partneriteteve strategjike me institucione në vendet e preferuar në Evropë dhe më gjerë. Në mënyrë të veçantë, duke u përqendruar në dy-tre universitete, këto lidhje do të analizohen në drejtim të bashkëpunimit, shkëmbimit të dokumentacionit shkollor, sidomos përkthimit të teksteve dhe hapjen e programeve të reja studimi për tre nivelet e shkollimit.	3 vite	DZHMJ+Fakultetet
	3. Ripërcaktim në mënyrë të qartë i rrjetit ekzistues të marrëveshjeve ndërkombëtare me prioritet cilësinë dhe efektivitetin e dëshmuar me anë të bashkëpunimeve. Do të pasqyrohen në faqen zyrtare elektronike të gjitha universitetet partnere dhe marrëveshjet e bashkëpunimit të hartuara. Në këtë drejtim do të rigjallërohen dhe do t'u jepet fuqi marrëveshjeve dhe programeve të shkëmbimit të pedagogëve e studentëve. Sipas programeve të ndryshme të mbështetura nga Komuniteti Evropian si: Long life learning, ERASMUS-Plus, Credit Mobility etj.	2 vite	DZHMJ
	4. Rritja e numrit të konferencave dhe seminareve ndërkombëtare të organizuara në Universitetin e Shkodrës e cila do t'i jepte një dimension më të madh ndërkombëtarizimit.	3 vite	Fakultetet



4. Përmirësim i burimeve dhe të infrastrukturës për të mbështetur bashkëpunim ndërkombëtar.	1. Sigurim i aksesit online free për stafin akademik/kërkuesit dhe studentat (për t'u njohur me të rejat e fundit në çdo fushë studimi) të USH-së në librari dixhitale multidisiplinare. Njohja me të rejat e fundit në fushat kërkimore përkatëse, ndihmon pedagogët të jenë më pranë kolegëve të tyre në universitetet e huaja, përsa I përket cilësisë së punimeve, duke rritur mundësinë për publikime kërkimore-shkencore në revista apo konferenca ndërkombëtare me faktor impakti të konsiderueshëm.	3 vite	IT+DMZHJ+ Fakultetet
	2. Dega e Zhvillimit e Marrëdhënive me Jashtë është një degë mjaft e rëndësishme e strukturës së Universitetit. Në këtë kontekst kjo degë duhet të ketë një rritje të kapaciteteve njerëzore. Aktualisht stafi i kësaj dege përbëhet nga 2 persona që janë të angazhuar full-time. Me qëllim përmirësimit e infrastrukturës së përgjithshme të mbështetjes dhe përgatitjes së projekteve është e domosdoshme rritja e stafit.	3 vite	DMZHJ
5. Përdorimi më efikas i Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit për të lehtësuar ndërkombëtarizimin e USH.	1. Përkthimi i të gjithë info të ëeb të USH në gjuhën Angleze (dhe në një plan më afatgjatë edhe në ndonjë gjuhë tjetër, psh gjuhë gjermane, frengje ose italiane).	1 vit	DMZH+IT
	2. Përkthim i Buletineve shkencore në gjuhën angleze, dhe publikim i përkthimeve në ëeb site të USH-së.	3 vite	DMZHJ+IT
	3. Implementim të tools-ve ICT si: --e-learning: për menaxhimin e kurseve online nëpërmjet LMS si MOOCs, WebCt, GoogleSite etj, ku të gjithë pedagogët efektive pa-perjashtim të përdorin të njëjtin sistem duke krijuar nga një profil user-i për secilin) --m-learning (mobile-learning duke përdorur aplikacione në paisjet smartphone) --video-konferenca (nje mundësi për t'i ofruar studentëve të jenë pjese e ligjëratave nga pedagogë të ftuar, ekspertë në fusha të ndryshme jashtë vendit.	2 vite	IT+Fakultetet

**Aneksi Nr 1. Përvojat e Fakulteteve të USH për partneritet e mësimdhënies**

- Stafi i FE ka realizuar mobilitete dhe ka fituar eksperiencat më të mira perëndimore në kërkim dhe mësimdhënie. Vlen të përmendet fakti se shkëmbimet kanë qenë të dyanshme, jo vetëm stafi i FSH ka lëvizur drejt Universiteteve europiane dhe amerikane, por edhe pedagogë nga këto universitete kanë dhënë mësim pranë FE.
- Nga bashkëpunimi i FGJH me Universitetin e Gracit dhe të Firences, janë ngritur programet e studimit, si dhe janë ftuar profesorë për të kontribuar në mësimdhënie dhe në ofrimin e përvojës së përparuar amerikane, angleze, austriake, italiane dhe frënge. Ky fakultet bashkëpunon me Ambasadën Amerikane dhe Korpusin e Paqes në Shqipëri, Ambasadën Italiane, CISVA (Centro Interuniversitario degli Studi del Viaggio Adriatico) dhe Ambasadën Franceze të cilat kanë siguruar pedagogë të kualifikuar dhe mbështesin përhapjen e gjuhës dhe kulturës së vendeve që ato përfaqësojnë. Në kuadër të bashkëpunimit, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ka ofruar profesorët e tij për të ndihmuar në mësimdhënie dhe për të përcjellë përvojën akademike shqiptare në Universitetin Shtetëror të Tetovës. Këtu vlen të përmendet fakti se si rezultat i bashkëpunimit me institucione homologe të huaja është arritur që në këtë Fakultet të punojnë më kohë të plotë pedagog nga Austria, Italia dhe Franca.
- FSHE ka marrëveshje bashkëpunimi me universitetin e Colorados në Sh.B.A, ndërkohë që vazhdon bashkëpunimi mes pedagogëve të këtij fakulteti me Universitetin e Podgoricës në drejtim të procesit të mësimdhënies.
- Falë projekteve ndërkombëtare, anëtarë të stafit akademik dhe studentë të FSHSH kanë marrë pjesë në projekte dhe shkolla verore në Bullgari, Slloveni, Kalabri si referues dhe lektorë ku mund të përmendim: Quality in Research” Tempus Project, 2012-2014; Shkollat Ndërkombëtare DIANET që janë organizuar si rezultat i pjesëmarrjes së USH-në Konferencën e Rektorëve të Alpe-Adriatikut; *Innovation and Tools to support Research and Mobility – DIAnet Final Event*”, Universiteti i Triestes, Itali; *1<sup>st</sup> Danube Future Workshop* – Universiteti Alpen Adria, Klagenfurt, Austri; Departamenti i Gjeografisë – bashkë - organizator me Sondor dhe RisiAlbania në projektin; “Kurs trajnimi për Guida Turistike”;
- Në vitin 2009-2011 departamenti i matematikës mori pjesë në projektin Tempus “Doctoral studies in Balkan countries”. Në kuadër të këtij projekti u bë e mundur bashkëpunimi me Departamentit e Inxhinierise Elektrike te Universitetit të Beogradit. Profesori i njohur Veljko Milutinovic, Felloë of the IEEE u angazhua në mësimdhënie për një periudhë 5 vjeçare në degën e Informatikës.
- Një marrëveshje e rëndësishme është ajo me Universitetin e Firences dhe si rezultat i saj është bërë edhe hapja e programit të studimit të Fizioterapisë në Universitetin e Shkodrës. 35 pedagogë nga Universiteti i Firences japin mësim në Universitetin e Shkodrës, si dhe është krijuar mundësia që studentë të këtij programi studimi të bëjnë praktikën e tyre profesionale në Firence.
- FSHN fton në periudha të caktuara kohe, personalitetet kërkimore shkencore nga Mali i Zi, Austria, Hollanda, Italia, Gjermania dhe Serbia.

**Aneksi Nr 2. Modulet në gjuhën angleze të ofruara nga USH**

- *Fakulteti Ekonomik (Faculty of Economy):* Biznes Ndërkombëtar (International business); Menaxhimi global i biznesit (Global management of business); Strategjia, politikat dhe qeverisja e korporatave (Strategy, policies and corporate governance); Makro (Macroeconomics); Mikro (Microeconomics); Ekonomiksi Ndërkombëtar (International economics); Menaxhimi i cilësisë (Quality management); Menaxhimi i sipërmarrjeve të reja (Management of new enterprises); Statistika (Statistics)
- *Fakulteti i Shkencave të Edukimit (Faculty of Educational Sciences):* Psikologjia e zhvillimit (Development psychology); Liderhipi në organizata (Leadership in organisations); Hyrje në psikologjinë organizative (Introduction to organisational psychology); Psikologjia e sportit (Sports psychology); Psikologjia e shëndetit (Health psychology); Psikologjia e zhvilluar ligjore (Advanced Law psychology); Këshillim grupi (Group advising); Socilogji (Sociology); Antroplogji (Anthropology)
- *Fakultetit i Gjuhëve të Huaja (Faculty of Foreign Languages):* Programi i plotë i studimeve Amerikane dhe Angleze (A full program of study in English and American studies)
- *Fakulteti i Shkencave Shoqërore (Faculty of Social Sciences):* Gjuhë kompjuterike (Natural Language Processing)

**Aneksi Nr 3. Përvoja e USH në mobilitetin e studentëve**

- Në FSHSH kanë dhënë module ose leksione të hapura pedagogë nga Universiteti i Kalabrisë, Universiteti i Palermos dhe Universiteti i Denverit. Katër pedagogë të këtij fakulteti japin mësim në Universitetin e Podgoricës. Në kuadër të marrëveshjeve dhe projekteve të ndryshme pedagogët janë përfshirë si lektorë në shkolla verore ndërkombëtare. Këtu mund të përmendim: Programin Ceopus; Projektin Tempus me titull “Quality in Research” ku janë përfshirë edhe studentë të doktoraturës; Pjesëmarrje si lektore në shkollën verore Go EAST – Sommerschule.
- Fakulteti Juridik ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi (Credit Mobility, KA1) me Universitetin e Seconda Università degli Studi di Napoli. Kjo marrëveshje pritet të fillojë zbatimin e saj në vitin akademik 2017- 2018 dhe synon të nxisë mobilitetin e stafit akademik dhe të studentëve të këtij Fakulteti. Bashkëpunimi shumë i frytshëm për departamentin e matematikës ka qenë ai me universitetin e Agder-Kristiansand- Norvegji. Bashkëpunimi u mbështet mbi një memorandum bashkëpunimi dhe solli si rezultat dërgimin e 10 studenteve tanë për të kryer master shkencor në mësimdhënien e matematikës pranë këtij universiteti.
- Vitin e fundit (2016-2017) janë hartuar marrëveshje për mobilitetin e studentëve të degës së matematikës me Universitetin e Kamerinos, Itali dhe për studentët e biologji – kimisë me Università della Campagna di Napoli.

**Aneksi Nr 4. Bashkëpunimet e USH për hartimin e kurrikulave ndërkombëtare**

- Për 10 vite (1993 – 2002), FE ka bashkëpunuar me Universitetin e Illinoisit të Jugut në Sh.B.A., me një ndikim të fuqishëm në krijimin e bazave e në konsolidimin e Fakultetit Ekonomik dhe në ngritjen e kurrikulave me orientim të shkollës amerikane të biznesit.
- FSHE ka patur marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Solothourn në Zvicër për periudhën 2005-2015. Janë realizuar dy projekte midis këtij fakulteti dhe atij të Solothourn si “Teatri i Kukullave me çorape“, “Teatri i hijeve” ku tematika të tyre janë përfshirë edhe në syllabuse të lëndëve artistike në programet e studimit të departamentit të mësuesisë. Janë shkëmbyer vizita ndërmjet dy vendeve mes pedagogëve dhe studentëve në mënyrë reciproke dhe janë realizuar trajnime.
- Fakulteti Juridik në bashkëpunim me Universita degli studi della Campania “Luigi Vanvitelli” ka në fazën e miratimit të kursit të parë italo-shqiptar në fushën e drejtësisë që në fund parashikon zotërimin e një diploma të përbashkët.
- Po ashtu Departamenti i Infermierisë është i përfshirë në projektin me titull: 544169-TEMPUS-1-2013-1-BE-TEMPUS-JPCR (Competency Based Curriculum Reform in Nursing and Caring in Western Balkan Universities). Me anë të këtij projekti synohet përafrimi i kurrikulës me ato të Universiteteve perëndimore.

**Ankesi Nr 5. Lista e projekteve ndërkombëtare të zhvilluara në USH**

Më poshtë është lista e **projekteve ndërkombëtare** që janë zhvilluar në Universitetin e Shkodrës dhë që janë të ndarë në projekte: me shumë partner; me një partner të vetëm; grante për mobilitete individuale; CEEPUS; Financime nga burime të tjera Projektet e zhvilluara nga viti 2008 deri 2016:

- Tempus Joint Project ETF-JP-00199-2008 , 144703-TEMPUS-1-2008-1-BA-TEMPUS-JPCR- “See Doctorial Studies in Mathematical Sciences”
- Tempus Joint Project, ETF-JP-00442-2008 144949-TEMPUS-1-2008-1-AT-TEMPUS-JPCR- “Example of excellence for joint (Degree) Programme Development in South-Eastern Europe”
- “Labororit te zhvillimit lokal njerëzor të Shkodres”. Ky projekt organizohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në bashkëpunim me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Programi I PNUD-it ART GOLD 2, Programi I UNOPS-it UNIVERSITAS, Keshilli i Qarkut Shkoder, Bashkia Shkoder, Agjensia për Zhvillim Lokal Ekonomik të Shkodres TEULEDA dhe Universiteti “Luigj Gurakuqi”.
- Erasmus Mundus External Cooperation Ëindoë, Lot 11, 2008-2011 (Basileus). Coordinator Gent University
- "Dva jezika jedna knjiga - Dy gjuhë një libër" projekt malazezo-shqiptar. IPA Cross-Border Programme Albania-Montenegro, 2007-2013 IPA 2007 annual allocation
- Quality in research, Grant agreement number: 2011-2517/001-001, Tempus -1-2011-1-BA-Tempus JPGR
- "Developing Third Mission activities in Albanian Universities, Agreement number 530243- TEMPUS-1-2012-1-ES- TEMPUS-SMHESIP02
- Competency Based Curriculum Reform in Nursing and Caring in Eastern Balkan Universities- 544169-TEMPUS-1-2013-BE-TEMPUS-JPCR



- Sport Professions- Education, Employment, Development in the Balkan Region -544362-TEMPUS-1-2013-1-IT-TEMPUS-JPCR
- TEMPUS- “CHTMBAL- Netëork for Post Graduate Masters in Cultural Heritage and Tourism Management in Balkan Countries” -517471 -1-2011- 1- IT
- Modernizing and harmonizing maritime education in Montenegro and Albania-544257-TEMPUS-1-2013-1
- Empowering Universities to fulfil their responsibility for Quality Assurance’ (EUREQA)- 530631 - TEMPUS - 1 - 2012 - BE- TEMPUS – JPGR
- Finanacial management, Accounting and Controlling curricula development for capacity building of public administration / FINAC),
- Credit Mobility (Universitet e Vechtas Gjermani, Varna, Bullgari, Universitetin e Prages dhe Ostroves, Çeki, Krakowit dhe Varshavës Poloni, Italo Forico, Kamerinos dhe Seconda Universita di Napoli, Itali)
- Sigma, agile





Aneksi Nr 6. Tabela e marrëveshjeve të Credit Mobility (KA1)

Periudha e marrëshjes	Universiteti pritës	Fusha e studimit	Cikli i studimit	Outgoing Student numri dhe muajt	Outgoing Staff numri dhe muajt ditët	Incoming Staf ose Student Number months
2015-2020	<u>Universiteti i Vechtas, Gjermani</u>	Arte dhe shkencat humane Busines – Administratim	1 dhe 2	1: 3x6 muaj 2: 2x6 muaj	Academic: 4x5 ditë academic: 12x5 ditë	x
2015-2020	Universiteti i Varnës Bullgari	Busines – Administratim	1 dhe 2	1; 3 x 3 muaj	Academik: 1x5 ditë	x
2015-2020	Universiteti i Almeiras Spanjë	Busines – Administratim	1 dhe 2	1; 3 x 5 muaj	X	x
2015-2020	Universiteti i Pragës Çeki	Busines – Administratim	1	1; 1 x 5 muaj	Academik; 1 x 5 ditë	x
2015-2020	Universiteti i Krakovit, Poloni	Busines – Administratim	1	1 ; 2 x 5 muaj	Akademik: 2x5 ditë; Administrativ 2x5 ditë	x
2015-2020	Universiteti Furo Italico, Itali	Shkencat sportive	1 dhe 2	1; 1x 5 muaj 2; 1 x 5 muaj	Academic; 1 x 5 dite Administrativ 1 x 5 ditë	x
2015-2020	Universiteti i Ostroves, Ceki	Busines – Administratim	1	1st; 1 x 5 muaj	Academik; 1 x 5 ditë	Akademik; 1 x 5 ditë



## STRATEGJIA E NDËRKOMBËTARIZIMIT E USH 2017-2020

2015-2020	Universiteti i Varshvës, Poloni	Business – menaxhim; Shkencat e edukimit, mësuesi, gjuhësi	2	2; 2 x 5 muaj	Administrativ	1 x 5 ditë	
2015-2020	Universiteti i Kamerinos, Itali	Matematikë	1 dhe 2	1st; 1 x 6 muaj; 2; 1 x 6 muaj	Akademik	Akademik;	1 x 15 ditë 1 x 15 ditë



### Aneksi Nr 7. Të dhëna mbi mobilitetin në USH

Tabela e mëposhtme tregon mobilitetet e stafit akademik në vite:

Viti	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Totali i mobiliteteve	47	70	21	21	33	45	26	20	38	21	19	20	34	32	49	51	39

- Në kuadër të programit Ceepus gjatë viteve të fundit 2 lektorë nga Universiteti i Montenegros, 1 lektor nga Universiteti i Bosnies dhe Hercegovinës, 1 lektor nga Universiteti i Beogradit, 1 lektor nga Universiteti i Vjenës kanë dhënë cikël leksionesh në Fakultetin Ekonomik. Pesë vitet e fundit në fakultetin Ekonomik kanë dhënë kontributin e tyre disa profesorë nga Universiteti i Denverit (SHBA), Bolonjës (Itali) apo edhe universitete të tjera evropiane.
- Në Fakultetin e Shkencave të Edukimit gjatë shumë viteve kanë dhënë kontributin e tyre dy lektorë nga Universiteti i Denverit (SHBA).
- Po kështu edhe në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja kanë dhënë dhe vazhdojnë të japin mësim profesorë me kohë të plotë nga Austria, Italia, Franca dhe Amerika. Këto profesorë japin mësim pranë 3 Departamenteve të Gjuhëve të Huaja.
- Profesorë nga Universiteti i Kalabrisë dhe ai i Prishtinës japin mësim më kohë të pjesshme në fushën e gjuhësisë pranë Departamentit të Gjuhës Shqipe. Po në këtë Fakultet profesorë nga universiteti i Denverit, USA kanë dhënë cikël leksionesh në Fakultetin e Shkencave Shoqërore pranë Departamentit të Historisë.
- Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës profesorët nga Mali i Zi, Austria, Hollanda, Italia, Gjermania dhe Serbia kanë dhënë mësim me kohë të pjesëshme pranë Departamenteve të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës. Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit mes Universitetit të Shkodrës dhe Universitetit të Firences, Itali, 20 pedagogë nga ky Universitet vijnë dhe japin mësim në Departamentin e Fizioterapisë.

Erasmus Mundus që kanë nxitur mobilitet. Në kuadër të këtyre projekteve mund të përmendim projektet me titull:

- Basileus- Erasmus Mundus - full partner; (4 student)
- Critical skills learning for innovation, sustainable growth, mobility and employ ability in the multicultural environment of the Western Balkans. “Sigma Agile” (full partner);
- Green-Tech-WEB: Smart and Green technologies for innovative and sustainable societies in Eastern Balkans (Associate partner); (2 staf akademik)
- Quality in research. (2 profesorë, 4 studentë)

Një rol të rëndësishëm ka luajtur edhe programi CEEPUS. Në këtë program ka pasur shume studente dhe profesorë si shqiptarë ashtu dhe të huaj që kanë realizuar mobilitet e tyre ndër vite.

Më poshtë është tabela përkatëse e mobiliteteve të CEEPUS

Viti	Pedagogë shqiptare	Studentë Shqiptare	Pedagogë te Huaj	Studentë të huaj
2006	3	2		
2007	5	7	3	
2008	5	7		



2009	3	2	2	2
2010	3	6		1
2011	2	6		3
2012		4		
2013	2	2		
2014		1		
2015				1

Përsa i përket të ardhmes, Universiteti i Shkodrës është fitues i 10 projekteve Credit Mobility të cilët nxisin e mobilitetin e ndërsjelltë të stafit akademik, administrativ si dhe të studentëve. Më konkretisht është arritur marrëveshja me Universitetet që vijojnë: Universiteti i Varnës (Bullgari); Universiteti i Krakovit (Poloni); Universiteti i Varshavës (Poloni); Universiteti i Almerias (Spanjë); Universiteti Vechta-s (Germany); Universiteti Foro Italico (Itali); Universiteti i Pragës, Çeki; Universiteti i Otroves, Çeki; Universiteti i Kamerinos, Itali; Seconda universita degli studi di Napoli, Italy. Këto mobilitete kanë filluar të zbatohen dhe do të vazhdojnë deri ne vitin 2020. Tabela e mobiliteteve të projekteve Credit Mobility gjendet në shtojcën 6.

### **Përgatiti:**

- Prof.dr. Adem Bekteshi,
- Prof.dr. Anila Neziri,
- Dr. Drita Brahimi,
- Dr. Arjola Halluni (Dergjini)
- Dr. Ledjana Xhakollari
- Ma. Erard Çurçija,
- Ma. Lidia Lacaj
- Msc: Lisana Berberi,

### **Mirëmbajtja dhe azhurnimi i strategjisë Sektoriale:**

- Ma. Lidia Lacaj
- Dr. Arjola Halluni(Dergjini)
- Dr. Drita Brahimi